



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 25.10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9426, DATË 6.10.2005, “PËR MBARËSHTIMIN E BLEGTORISË”, TË NDRYSHUAR

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9426, datë 6.10.2005, “Për mbarështimin e blegtorisë”, në mbledhjen e datës 18 tetor 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

1. Qëllimi i projektligjit

Projektligji synon liberalizimin e veprimtarisë së ndërzimit natyror të kontrolluar. Kjo propozohet të bëhet me shfuqizimin e licencës “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)” me kodin II.2.A.2.

Gjithashtu, projektligji, parashikon edhe detyrimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e ndërzimit natyror për të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie edhe kryerjen e kësaj veprimtarie.

2. Argumentimi për ndryshimin

Argumentimi për këtë ndryshim lidhet me reformën e derregullimit e cila synon liberalizimin e tregut për këtë veprimtari, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, si dhe synon krijimin e lehtësirave për përmirësimin e klimës së biznesit.

Pas miratimit të këtij projektligji do të ndërhyhet edhe në VKM 538/2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit” për të shfuqizuar licencën për këto stacione ndërzimi.

3. Risia

Ndryshimi i propozuar do të ndikojë në krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative.

Diskutimet në Komision u fokusuan te funksionimi aktual i kësaj veprimtarie, si dhe te ndikimi që ka ky ndryshim në përmirësimin e klimës së biznesit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Besnik BARAJ

Eduard SHALSI

Relator

Kryetar